



P Z A P
I P Ž P

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.394/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët Arsim Hamzaj - kryesues, Kymete Kicaj dhe Skender Çoçaj - anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 07.02.2025, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, Anr.394/2025 të datës 05.02.2025, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë.

A r s y e t i m

Me datë 05.02.2025 PZAP ka pranuar ankesën Anr.394/2025 nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me të cilën pretendon se më datë 5 Shkurt 2025, Donard Spahija, mbështetës i subjektit politik PDK, ka ripostuar në profilin e tij në Facebook, një fotografi të Kryeministrit z. Albin Kurti dhe të bashkëshortes së tij Rita Augestad Knudsen, në cilën është përdorur gjuhë fyese dhe denigruese për qëllime të fushatës dhe me qëllim të vazhdimit të dëmtimit elektoral dhe nxitjes së urrejtjes ndaj Kryeministrit z. Albin Kurti, duke e quajtuar "Kryeministër BATALL' qen endacak". Parashtresi i ankesës theksuar se përmes këtij veprimi mbështetësi/ simpatizanti i partisë politike PDK dhe subjekti politik PDK ka shkelur dispozitat e nenit 34. paragrafi 1, pika 1.11 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë. Si dëshmi ka bashkangjitur fotografin dhe linkun: <https://www.facebook.com/donard.spahija>

Në përgjigje në ankesë të paraqitur, subjekti politik PDK ka kundërshtuar ankesën e paraqitur nga subjekti Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dhe kanë theksuar se përmes kësaj përgjigje, PDK konsideron se në mungesë të argumentimit të përgjegjësisë subjektive të PDK nga ana e ankuesit, është e pamundur që PDK të argumentoj që të njëjtët nuk janë mbështetës apo votues

i PDK-së, mirëpo PDK garanton se personat të cilat janë objekt i kësaj ankesë, nuk janë pjesë e strukturave partiake dhe nuk përfaqësojnë subjektin e tyre politik, megjithëse detyrimi për të argumentuar se të njëjtë janë pjesë e strukturave, apo përfaqësues, mbështetës apo aktivistë të PDK-së i përket ekskluzivisht ankuesit. Andaj, te njëjtë vlerësojnë se pretendimi se personi i përmendur në këtë ankesë është simpatizant dhe aktivistë i PDK-së, vetëm për faktin se ka postuar postime kundër LVV, pa bashkëngjitur asnje provë e cila do të vërtetonte në mënyrë të pakontestueshme këtë fakt, është i paqëndrueshëm dhe si i tillë i pabazuar.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën gjeti se:

Ankesë është e pabazuar

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga subjekti politik PDK, vlerësoj se pretendimet e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11, të LZP-së, me të cilën përcaktohet: "Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjërsi si në vijim: përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjeter për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjera ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjereve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjeter që ka ose mund të ketë ndikim të tillë".

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës lidhur me shkeljen e pretenduar nga ana e subjektit politik PDK, Paneli i vlerësoj se janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin ndonjë nga shkeljet e pretenduara, kjo pasi që parashtruesi i ankesës, në ankesë e ka bashkangjitur postimin e personit në fjalë, mirëpo me asnjë provë nuk ka mundur të vërtetohet se i njëjtë është mbështetës apo aktivist të PDK-së.

Paneli me rastin e shikimit të shkresave të lëndës, vlerësoi se ankesë është e pabazuar pasi që nga provat e ofruara si dëshmi të cilat parashtruesi i ankesës i ka bashkangjitur si dëshmi, nuk mund të vërtetohet se në cilën kohë ka ndodhur shkelja e pretenduar për të cilën referohet pala ankuese. Andaj duke u mbështetur në nenin 17.3 të LZP-së ku përcaktohet se: "vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse ", Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë dhe nga provat e ofruara si dëshmi parashtruesi i ankesave nuk ka arritur që të vërtetoj pretendimet e theksuara si më lart.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, nenin 118 paragrafi I të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.394/2025 më datë 07.02.2025



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.